

VENDIM
Nr. 155, datë 17.7.2025

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN
(NËPËRMJET KONTRATËS SË HIPOTEKËS DHE MARRËVESHJES SIGURUESE)
TË ASETVE FIKSE TË SHOQËRISË “DIMAX ALBANIA” SHPK**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, germa “b”; 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1591/13 prot., datë 11.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit, dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Dimax Albania’ sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet kontratës së hipotekës dhe marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj”,

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “Dimax Albania” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1591 prot., datë 23.4.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Dimax Albania” sh.p.k është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhimi 2 mw, në zonën Povelçë, qarku Fier, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 308, datë 30.11.2022.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1591 prot., datë 23.4.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 102, datë 12.5.2025, vendosi të fillojë procedurën për dhënie e autorizimit, lidhur me aplikim e shoqërisë. Për këtë vendim, ERE ka njoftuar edhe MIE-n nëpërmjet shkresës me nr. 1713 prot., datë 14.5.2025. Ndërsa me shkresën nr. 1591/3 prot., datë 14.5.2025, ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet.

- Në vijim, shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1591/4 prot., datë 28.5.2025, depozitoi një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, nga analizimi i të cilit u konstatua se në marrëveshjen siguruese të depozituar, pjesë e së cilës është e lista e detajuar e aseteve fikse me vlerat përkatëse, vlera totale e pasurisë objekt barrësimi rezulton më e vogël se 150,000,000 lekë. Për këtë arsye, ERE, nëpërmjet shkresës me nr. 1591/5 prot., datë 11.6.2025 i risolli në vëmendje shoqërisë, se, referuar rregullores në fuqi, procedura për miratimin e transferimit të aseteve aplikohet vetëm në rastet kur vlera e tyre është më e madhe se 150 milionë lekë, dhe për këtë arsye kërkohet sqarim shtesë.

- Në përgjigje, shoqëria nëpërmjet shkresës me nr. 1591/6 prot., datë 18.6.2025, ka shprehur se janë të paqartë ndaj kërkojnë një takim sqarues në lidhje me kërkesat për transferimin e aseteve.

- ERE, me shkresën nr. 1591/7 prot., datë 20.6.2025, nisi njoftimin për zhvillimin e një seance dëgjimore në datë 23.6.2025, shkresë e cila iu dërgua shoqërisë edhe nëpërmjet me *e-mail*-it po në të njëjtën datë. Shoqëria me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 1591/8 prot., datë 20.6.2025, konfirmoi pjesëmarrjen në seancën dëgjimore.

- Seanca dëgjimore ndërmjet ERE-s dhe përfaqësuesve të shoqërisë u zhvillua më datë 23.6.2025, ku këto të fundit sqaruan se do të saktësonin listën e aseteve me bankën, e në vijim, në rast se vlera do të ishte nën 150,000,000 lekë, atëherë shoqëria do të kërkonte mbyllje të procedurës, në të kundërt, do të përcjellin dokumentacionin e munguar, pra listën e aseteve përkatëse, sa më parë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1590/10 prot., datë 30.6.2025, shoqëria depozitoi marrëveshjen siguruese, pjesë e së cilës është dhe lista e aseteve fikse.

- Për sa shqyrtuar, u vlerësua të dërgohej një *e-mail*/bankës dhe shoqërisë nga adresa zyrtare e ERE-s, në datë 10.7.2025, protokolluar me nr. 1591/11 prot., datë 10.7.2025, pasi u evidentua se lista e aseteve e depozituar ishte nënshkruar vetëm nga shoqëria dhe jo nga banka, si dhe se në listën e depozituar nuk përfshihej toka si aset, pavarësisht se mund të jetë pjesë e objektit të barrës siguruese. Për këtë arsye, ERE ka kërkuar që, nëse toka është pjesë e barrës, ajo të përfshihet si pjesë integrale e listës së aseteve që kërkohet të miratohen. Palëve iu vendos afat për kthimin e përgjigjes brenda së njëjtës ditë. Rezulton se shoqëria ka dërguar informacionin e kërkuar brenda afatit të caktuar, përmes *e-mail*-it të datës 10.7.2025, i protokolluar në ERE me nr. 1591/12 prot., datë 11.7.2025.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analizimi përfundimtar i dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Dimax Albania” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 4, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, si vijon

4. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- **Pika 1** – Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi kërkesën për transferim, ndër të tjera si më poshtë vijon:

- **germa “a”** – është depozituar ekstrakti historik i shoqërisë;
- **germa “b”** – është plotësuar aktiviteti për të cilën shoqërisë është licencuar;
- **germa “c”** – janë depozituar pasqyrat financiare të shoqërisë;
- **germa “d”** – është bërë përshkrimi i kandidatit tek i cili do të transferohet asetet;
- **germa “e”** – shoqëria ka argumentuar arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit.
- **germa “h”** – janë depozituar marrëveshjet përkatëse;
- **germa “i”** – është depozituar deklarata përkatëse;
- **germa “j”** – shoqëria nuk ka pasur transferime të mëparshme.

- **Pika 4** – Kërkesa për aplikim është nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërsa dokumentet e tjera shoqëruese të këtij aplikimi janë nënshkruar nga administratori dhe/ose personat e autorizuar sipas rastit.

- **Pika 6** – Shoqëria nuk ka specifikuar dhe as ka bërë me dije nëse ndonjë pjesë e dokumentacionit të përcjellë kërkohet të trajtohet si konfidenciale, apo të mos jetë e hapur për publikun; për rrjedhojë, konsiderohet se një kërkesë e tillë nuk është paraqitur.

5. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të saj (sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi), si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi asetet e shoqërisë për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e saj, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Dimax Albania” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet kontratës së hipotekës dhe marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a. (që rrjedhin nga kontrata e kredisë dhe e hipotekës datë 23.8.2023 dhe marrëveshja siguruese datë 27.6.2025). (Lista e aseteve bashkëlidhur).

2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 nuk e çliron shoqërinë “Dimax Albania” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “Dimax Albania” sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet fikse të saj që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast se shoqëria dokumenton heqjen e hipotekës dhe barrës siguruese të radhës së parë të vendosur mbi asetet e saj.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Dimax Albania” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyjnë në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

"Lista e aseteve të shoqërisë DIMAX ALBANIA sh.p.k."

1. Panele fotovoltaike $P_{max} = 650W$, të kompletuara me konstruksionin përkatës dhe aksesorë, me vlerë 106,302, 185 lekë;

2. Kabinë transformacioni e kompletuar me inverter, transformator fuqie 2.4MVA, çela TM 35kV, sistem monitorimi, me vlerë 26,746,562 lekë;

3. Kabllo DC për lidhjen e vargjeve 2x6 mm², me vlerë 2,562,367 lekë;

4. Kabllo DC për lidhjen e kasetave të xhuntimit me kabinën e transformacionit 3x400x185mm², me vlerë 3,089.550 lekë;

5. Kabllo TM 35 kV për lidhjen e kabinave të transformacionit me sallën e komandës 1x185/25 mm², me vlerë 446.440 lekë;

6. Kabllo të ndryshëm për lidhjet e ndërmjetme, me vlerë 500.561 lekë;

7. Tuba korrogato për kabllot e vargjeve, me vlerë 1,094.535 lekë;

8. Rrufepritisë, me vlerë 23,096 lekë;

9. Elektroda tokëzimi, me vlerë 90,993 lekë;

10. Morseta dhe fiksues për shirit metalik të galvanizuar, me vlerë 93.433 lekë;

11. Shirit metaik i galvanizuar, me vlerë 623,014 lekë;

12. Tub korrogato Ø 50mm, me vlerë 38,750 lekë;

13. Konstruksione metalike të thjeshta, me vlerë 978,322 lekë;

14. Sistem ndriçimi, me vlerë 1,014,905 lekë.

15. Pronë (pasuri e paluajtshme), me vlerë 7,521,696 lekë.

Në total *rezultojnë 151,126,408 lekë,*

tvsh 30,225,282 lekë,

ndaj totali aseteve me tvsh rezulton 181,351,690 lekë.